




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

*Nr.19, datë 19.09.2024*



**PËR**  
**SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES**  
**NR.48 prot., DATË 23.7.2018 DHËNË NGA KBU SHKUMBIN “PËR**  
**PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME**  
**INDUSTRIALE”,**  
**SUBJEKTIT “ALB TECH PLAST”**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

**V E N D O S I:**

1. Saktësimin e koordinatave të lejes nr. 48 prot., datë 23.7.2018 dhënë me vendim nr.36/2 datë 13.7.2018 nga Këshilli të Basenit Ujor Shkumbin si më poshtë:

Vendndodhja e veprës së marrjes (KRGJSH)

Nga: X= 475999.8; Y= 4545503.1; Z= 19.45 m.m.n.d

Në: X= 476989.7; Y= 4545418.4; Z= 18 m.m.n.d

Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=0.002 m<sup>3</sup>/s



2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes nr. 48 prot., datë 23.7.2018 dhënë me vendim nr.36/2 datë 13.7.2018 nga Këshilli të Basenit Ujor Shkumbin për “Përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime industriale” subjektit “Alb Tech Plast” sh.p.k me vendndodhje Fshati Gosë Peqin Qarku Elbasan.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

**KRYETARI I KBU SHKUMBIN**

**ALI MYSEIU**

